

SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61 paragrafi 61.3. lidhur me nenin 63 paragrafin 63.1.2. të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "Nara Biotics" të datës 31.05.2024 kundër njoftimit mbi vendimin të datës 28.05.2024 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "13 Furnizimi me material shpenzues stomatologjik llot IV - Ritender" me nr. të prokurimit 616-24-4043-1-2-1, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:




V E N D I M

- I. **MIRATOHET** si e bazuar kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "Nara Biotics" të datës 31.05.2024 kundër njoftimit mbi vendimin të datës 28.05.2024 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "13 Furnizimi me material shpenzues stomatologjik llot IV - Ritender" me nr. të prokurimit 616-24-4043-1-2-1 ashtu që **ANULOHET** njoftimi mbi vendimin i datës 28.05.2024 i autoritetit kontraktues lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.
- II. **DETYROHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të dërgoj në **RIVLERËSIM** aktivitetin e prokurimit nga pika I e këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHEN** palët e interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik "Nara Biotics" (tutje "parashtruesi") me datë 31.05.2024 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit mbi vendimin e datës 28.05.2024 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "13 Furnizimi me material shpenzues stomatologjik llot IV - Ritender" me nr. të prokurimit 616-24-4043-1-2-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës.

<p>Artikulli 37.</p> <p>Acid ortofosforik 37% gel (Shiringe min. 3.5ml)</p>		 <p>DESCRIPTION</p> <p>It removes the smear layer by polishing the enamel and dentin surface, it provides optimal bonding characteristics and long-term stability.</p> <p>Properties</p> <ul style="list-style-type: none"> Easy to use Non-abrasive Optimizes surface etching <p>Packaging</p> <ul style="list-style-type: none"> 1 x 3.5ml syringe 1 x 3.5ml syringe 1 x 3.5ml syringe
<p>Artikulli 42.</p> <p>Paste abrazive për polirim të mbushjeve estetike me mikrogramca diamantit 0.5-1µm, shiringe min. 3gr)</p>	 <p>Porcelain Laminare Polishing Paste is a non-aqueous, fine particle, pleasant-tasting paste that has a smooth-flowing consistency, providing the finest luster on composite, as well as porcelain restorations. Porcelain Polishing Paste produces superior polishing results and reduces material waste.</p>	<p>Kjo pastë nuk përkorn me atë çka është kërkuar nga AK</p> <p>Anglisht: Porcelain Laminare Polishing Paste is a non-aqueous, fine particle, pleasant-tasting paste that has a smooth-flowing consistency, providing the finest luster on composite, as well as porcelain restorations. Porcelain Polishing Paste produces superior polishing results and reduces material waste.</p> <p>Shqipe: Pasta lustruese e përzuar prej porcelani është një pastë ujore, grimca e imët me shije të këndshme që ka një konsistencë me rrjedhje të qetë, duke siguruar shkëlqimin më të mirë në përbërjet dhe në restaurimet prej porcelani. Pasta lustruese e porcelani prodhon rezultate superiore lustrimi dhe redukton mberjet materiale.</p>

Mbi bazën e dëshmive sikurse më sipër, është gjetur se artikujt me nr. 1, 26, 27, 37 dhe 42 të ofertuar nga tenderuesi i rekomanduar nuk janë në përputhje me përshkrimin e kërkuar sipas paramasaës - dosjes së tenderit të përcaktuar nga autoriteti kontraktues për arsyet e evidentuara edhe në dëshmitë e prezantuara sikurse më sipër. Në këtë mënyrë është gjetur se pretendimet ankimore janë të bazuara.


Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.1.2. të RPPP.

Për pikën III dhe pikën IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.2. të RPPP.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 06.06.2024

Visar SHEHU
 Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
 Komuna e Prishtinës



Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.